



OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendeve vakante **Specialist** pranë Departamentit Ligjor / Drejtoria e Procedurave të Shpronësimeve dhe i Marrëdhënieve Kadastrale / Sektori i Inventarizimit dhe Regjistrimit.

SPECIALIST

Sektori i Inventarizimit dhe Regjistrimit:

- Ky sektor është përgjegjës për administrimin e çdo çështje që lidhet me identifikimin, verifikimin, inventarizimin, regjistrimin e pasurive të paluajtshme të OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Administrimin e çdo çështjeje që lidhet me identifikimin, verifikimin, inventarizimin, regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shoqërive të Grupit, në përputhje dhe në zbatim të dispozitave dhe akteve nënligjore në fushën e inventarizimit, transferimit dhe regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- Plotëson listat e inventarit dhe të *database*-ve të pasurive të paluajtshme (në bashkëpunim me drejtoritë rajonale), përditësimin e tyre, si dhe hartimin e listave të reja;
- Krijimi, mirëmbajtja dhe përditësimi i faqeve *WEB* me të dhënat mbi pasuritë e paluajtshme, që përbën edhe objektin e punës së Drejtorisë së Regjistrimit dhe Inventarizimit të Pasurive të Paluajtshme;
- Ndjek procedurat administrative dhe ligjore të problemeve që paraqiten në Sektor, konfirmimet për të tretët brenda dhe jashtë OSHEE GROUP sh.a, nëse prona (objekt kërkesë) është përfshirë në listën e pronave të paluajtshme të OSSH sh.a. ose FSHU sh.a;
- Ndjek procesin dhe procedurën e regjistrimit, pranë Drejtorive Vendore të ASHK-së, të pronës së transferuar në pronësi të OSSH sh.a, dhe atyre të reja të fituara nëpërmjet lejeve të ndërtimit të objekteve me interes publik;
- Monitoron përpilimin e plotësimit të formularëve të përcaktuar sipas ligjit dhe llojit të pasurisë për pronat shtetërore, bazuar në informacionin e tërhequr nga ASHK-ja, relacioneve të Këshillit Mbikëqyrës për procese të ndryshme të Sektorit, etj.;



- Ndjek përgatitjen e materialeve hartografike (fragmenteve të hartës, etj.) për procesin e konfirmimit për institucionet dhe drejtoritë brenda dhe jashtë OSHEE GROUP sh.a;
- Bashkëpunimi me strukturat e marrëdhënieve me gjyqësorin, të Drejtorisë së Çështjeve Gjyqësore, përsa i përket konflikteve gjyqësore në çështjet me objekt pretendime pronësie (lirim / dorëzim sendi, vlerë përdorimi, etj.);
- Ngritja e padive në rastet e mosregjistrimit nga DVASHK-të të pasurive të paluajtshme me titull pronësie në emër të Shoqërisë, me qëllim arritjen e objektivave dhe përmbushjen e rezultateve të kërkuara nga kjo njësi organizative;
- Sugjeron dhe monitoron përgatitjen e materialeve të duhura informuese për drejtorinë, në lidhje me përgatitjen dhe përpilimin e listave të reja të inventarit, plotësimin e formularëve dhe përgatitjen e materiale hartografike, duke vlerësuar të gjitha mundësitë procedurale, në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e përgjegjësive të Drejtorisë.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.